



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA

GJAKOVA



Njësia e Prokurimit

Gjakovë, datë 31.10.2024

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Gjakovës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit mbi Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 63 (paragrafi 63.1.1) të Rregullores për Prokurim Publik /Nr.001/2022, të publikuar nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës 30.10.2024, të parashtruar nga Operatori Ekonomik RRUGA 07 L.L.C. lidhur me aktivitetin e prokurimit “Ndërtimi i shtegut dhe Shkugëza e sfidave”, Nr. i prokurimit- Nr. i prokurimit- 632-24-10879-5-2-1, Nr. i brendshëm-632-24-120-521, **nxjerr:**

V E N D I M

1. Refuzohet si e pabazuar kërkesa për ri-shqyrtim të Operatori Ekonomik RRUGA 07 L.L.C. e dt.30.10.2024, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Ndërtimi i shtegut dhe Shkugëza e sfidave”, Nr. i prokurimit- Nr. i prokurimit- 632-24-10879-5-2-1, Nr. i brendshëm-632-24-120-521, kundër DOSJES SË TENDERIT DHE NJOFTIMI PËR KONTRATË, të datës 21.10.2024, të publikuar në platformën elektronike të KRPP-së.

2. Vërtetohet DOSJA E TENDERIT DHE NJOFTIMI PËR KONTRATË, i publikuar me datë: 21.10.2024;

3. Autoriteti Kontraktues, vendos që të vazhdoj aktivitetin e prokurimit.

4. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe publikohet në platformën elektronike të KRPP-së .

A r s y e t i m

Operatori Ekonomik RRUGA 07 L.L.C. me dt.30.10.2024, ka parashtruar kërkesës për ri-shqyrtim, lidhur me aktivitetin e prokurimit “Ndërtimi i shtegut dhe Shkugëza e sfidave”, Nr. i prokurimit- Nr. i prokurimit- 632-24-10879-5-2-1, Nr. i brendshëm-632-24-120-521.



Autoriteti Kontraktues Komuna e Gjakovës, me datë 31.10.2024, ka shqyrtuar kërkesën në fjalë si më poshtë:

Pretendimet e juaja nuk qëndrojnë, sepse Autoriteti kontraktues e ka vlerësuar se kriteret e vendosura në FDT-ë, janë në përputhje me kushtet teknike dhe profesionale për këtë aktivitet i cili është specifik.

Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar në ato që u thanë më lart ka vendosur si në dispozitiv.

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së . Ankesa pranë OSHP-se duhet të dorëzohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimit të këtij vendimi.

Kopje: Operatorit Ekonomik;
Zyres së Kryetarit të Komunës;
Te gjitha palëve të interesuara;

Eaton Gutaj

Menaxher i Zyres së Prokurimit
